



Nr. K1/I129-5 Prot.
Nr. Dok. 202201613/5

Tiranë 02.05.2023

Lënda: *Rekomandim për marrjen e masave të menjëhershme për furnizimin normal me ujë të pijshëm dhe brenda kushteve higjieno-sanitare të fshatit Borakë, Njësia Administrative Sukth, Bashkia Durrës*

SHOQËRISË RAJONALE UJËSJELLËS-KANALIZIME DURRËS SH.A

BASHKISË DURRËS

Të nderuar,

Siç tashmë jeni në dijeni, institucioni i Avokatit të Popullit ka trajtuar me iniciativë rastin e bërë publik në media¹ lidhur me shqetësimin e banorëve minoritarë boshnjakë të fshatit Borakë në Sukth, të cilët kanë protestuar për furnizimin jo të rregullt me ujë të pijshëm. Ata pretendojnë se trajtohen në mënyrë të diferencuar si minoritarë, duke theksuar se atyre uji u shkon rrallë dhe në orët e vona të natës, ndryshe nga lagjet e tjera në këtë zonë. Banorët parashtruan se i janë drejtuar Ujësjiellës-Kanalizime sh.a. si dhe Bashkisë Durrës, por problematika e tyre nuk ka gjetur zgjidhje.

Në këto kushte, me qëllim garantimin e mbrojtjes efektive të të drejtave të këtij komuniteti, duke e konsideruar të drejtën e furnizimit të pandërprerë me ujë të pijshëm si një nga të drejtat kryesore që lidhen me cilësinë e jetës, shëndetin dhe mjedisin, në përputhje me nenin 13 të ligjit nr.8454 datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, kemi filluar me iniciativë ndjekjen e kësaj çështje.

Për nevoja të shqyrtimit të mëtejshëm të këtij rasti, me tonat nr. K1/I129-2 datë 23.01.2023 dhe nr. K1/I129-3 datë 23.02.2023 drejtuar Shoqërisë Rajonale të Ujësjiellës Kanalizime Durrës Sh.A. (në vijim edhe UKD) si dhe Bashkisë Durrës bazuar në pikën 4, të nenit 63, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në gërmën "b" të nenit 19 të ligjit nr. 8454 datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", kemi kërkuar informacion të hollësishëm lidhur me situatën, nëse qendron problematika e parashtruar, shkaqet ligjore që kanë ndikuar në krijimin e kësaj situate, masat që do të merren për normalizimin e situatës së krijuar për banorët e kësaj zone, si dhe çdo informacion tjetër që ka lidhje me këtë çështje.

¹ Banorët e fshatit Borakë protestë: Nuk kemi ujë të pijshëm, na diferencojnë se jemi minoritarë, link: <https://lapsi.al/2022/11/30/banoret-e-fshatit-borake-proteste-nuk-kemi-ujte-te-pijshem-na-diferencojne-se-jemi-minoritare/>

Në përgjigje të këtyre kërkesave, morëm përgjigje vetëm nga Shoqëria Rajonale e Ujësjellës Kanalizime Durrës Sh.A., me nr. 1379/3 datë 13.03.2023, drejtuar Avokatit të Popullit e për dijëni Bashkisë Durrës.

Përmes përgjigjes së sipërcituar përcillen shpjegime lidhur me shqetësimin e banorëve minoritarë boshnjakë të fshatit Borakë, për mungesën e furnizimit të rregullt me ujë të pijshëm. Përgjigja e sipërcituar është shoqëruar edhe nga procesverbali i mbajtur nga grupi i verifikimit në terren². Sipas informacionit të përcjellë, rezulton se pozicioni gjeografik i fshatit Borakë, në një zonë kodrinore, zonë fundore e furnizimit me ujë e cila është pika më e lartë jo vetëm e fshatit, por edhe e qytetit të Shijakut, e bën të pamundur furnizimin nga tubacioni kryesor i cili furnizon zonat rurale dhe një pjesë të qytetit të Durrësit. Sipas UKD, kjo kushtëzon furnizimin me ujë në dy fasha orare të papërshtatshme për banorët e zonës, duke krijuar kështu perceptimin se ata trajtohen në mënyrë të diferencuar:

- Nga ora 19⁰⁰-02⁰⁰ furnizim për zonën në fillim të kolektorëve;
- Nga ora 23³⁰-02⁰⁰, për zonën në pikën fundore të kolektorëve.

Këto orare, vijon përgjigja, mund të ndryshohen gjatë ditës për shkak të situatave të papritura që mund të paraqiten, siç mund të jenë defekte në tubacionin e transmissioinit, stakime të burimit të furnizimit për arsye teknike-elektrike, etj.

Më tej pohohet se, referuar kësaj problematike të hasur në lagjen “Kodër” të fshatit Borakë si dhe të faktit se furnizimi me ujë i këtij fshati është i diktuar në funksion të furnizimit me ujë të qytetit të Durrësit, specialistët e kësaj shoqërie të cilët kanë kryer verifikime në terren kanë arritur në konkluzionin se zgjidhja teknike e kësaj problematike do të ishte vendosja e një pompe me kapacitet të lartë përcjellës, e cila do të sigurojë furnizimin me ujë në sasinë dhe presionin e duhur, për të gjithë banorët e zonës së fshatit Borakë.

Në vlerësim të sa më sipër, rezulton se shqetësimi i ngritur nga banorët minoritarë boshnjakë të fshatit Borakë qëndron. Në rastin më të mirë furnizimi me ujë realizohet vetëm për 3 deri në 7 orë në 24 orë, të cilat përkojnë me orarin e darkës, duke kufizuar kështu furnizimin me ujë gjatë ditës.

Avokati i Popullit vlerëson se rasti i parashtruar më lart përbën shkelje të së drejtës së njeriut për ujë të pijshëm dhe higjienë, si çështje specifike këto të lidhura ngushtë me shëndetin, jetën dhe dinjitetin e njeriut.

Institucioni i Avokatit të Popullit, në mbrojtje të interesave të ligjshme të konsumatorit, veçanërisht për pakicat kombëtare, kërkon të sjellë në vëmendjen tuaj marrjen e masave për furnizimin me ujë të pijshëm, brenda gjithë kushteve higjieno-sanitare në mënyrë të vazhdueshme për këta banorë, si një nevojë emergjente.

E drejta e aksesit në ujë të pijshëm afirmohet si e drejtë e njeriut nga një sërë aktesh ndërkombëtare konkretisht, Direktiva e të Ministrave të BE (EU) 2020/2184³; Objektivat

² Procesverbal nr. 1379/2 datë 03.03.2023 i mbajtur nga Drejtori i Shpërndarjes së Ujit dhe Përgjegjësi i Sektorit të Transmetimit, mbi verifikimin dhe sqarimin e furnizimit me ujë të banorëve të fshatit Borakë, Njesia Administrative Sukth

³ DIRECTIVE (EU) 2020/2184 OF THE EUROPEAN PARLIAMENT AND OF THE COUNCIL of 16 December 2020 on the quality of water intended for human consumption. Link: <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:32020L2184>

për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Kombeve të Bashkuara⁴; Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së 58/217, “Ujë për gjithë jetën”⁵; Rezoluta e Këshillit të Drejtave të Njeriut 15/9, “Te drejtat e njeriut dhe aksesit në Ujë të Pijshëm dhe Higjenë (2010)”⁶. Në Udhëzuesin e Kombeve të Bashkuara për Mbrojtjen e Konsumatorit⁷, thuhet se: “*Qeveritë duhet që brenda objektivave dhe synimeve të përcaktuara në Dekadën Ndërkombëtare për furnizimin me ujë të pijshëm dhe për higjenën, të formulojnë, të mbajnë dhe fuqizojnë politikat kombëtare për të përmirësuar furnizimin, shpërndarjen dhe cilësinë e ujit të pijshëm.....*”.

Këto akte ndërkombëtare përbëjnë një kompleks normash që garantojnë aksesin në ujë, sigurinë e ujit të pijshëm, përshtatshmërinë e furnizimit dhe përballueshmërinë ekonomike, të drejtën për higjenë të pastër dhe mbrojtjen e shëndetit të njeriut, duke vendosur kështu kritere të detyrueshme për shëndetin dhe pastërtinë.

Institucioni i Avokatit të Popullit, krahas vlerësimit të përmbushjes së detyrave tuaja funksionale në drejtim të ofrimit të një shërbimi publik, ju vë në dukje faktin se, të drejtat e konsumatorëve për banorët e minoritetit boshnjak në këtë zonë, në drejtim të furnizimit me ujë brenda kushteve teknike dhe higjenike, janë kufizuar nga mosveprimi i vazhduar në kohë nga ana e autoriteteve përgjegjëse, që kanë detyrimin të ndërmarrin masa pozitive për përmbushjen e interesit jetik, të furnizimit me ujë të banorëve të fshatit Borakë.

Ligji Nr. 9902 datë 17.04.2008, “Për mbrojtjen e konsumatorit”, neni 4, pika “e”, ndër të tjera parashikon si të drejta bazë për konsumatorin edhe ofrimin e shërbimeve publike, që në rastin konkret nënkuptojnë furnizimin me ujë të pijshëm dhe sigurimin e standardeve për këtë shërbim. Çdo justifikim i përdorur për mosofrimin e këtij shërbimi jetik, në kushtet e evidentuara gjatë trajtimit të kësaj çështjeje, nuk është i qëndrueshëm dhe i arsyeshëm.

Ofrimi i shërbimit publik të furnizimit me ujin të pijshëm dhe cilësor, në gjykimin tonë është një nevojë thelbësore për individët dhe për rrjedhim, një e drejtë elementare për ta poseduar atë lirisht dhe në përputhje me standardet e kërkuara të cilësisë së ujit të pijshëm. Ndaj edhe çdo mospërmbushje apo keqmenaxhim i këtij shërbimi është një shkelje e drejtpërdrejtë e të drejtave të njeriut që nuk i përgjigjet standardeve minimale që duhet të plotësojë një vend kandidat për t’u anëtarësuar në Bashkimin Evropian.

Mungesa e furnizimit të rregullt me ujë të pijshëm jo vetëm që ndikon në cilësinë e jetës së banorëve të kësaj zone, por në këndvështrimin e jurisprudencës së Gjykatës Europiane të Drejtave të Njeriut, çënon të drejtën e tyre për gëzimin e qetë të shtëpive të tyre, si dhe çënon të drejtën për jetë të qetë private dhe familjare.⁸

⁴ Vecanërisht objektivi nr. 6, Sigurimi i disponueshmërisë dhe menaxhimi i qëndrueshëm i ujit dhe shërbimeve sanitare për të gjithë. Nënobjektivi 6.b parashikon mbështetjen dhe fuqizimin e pjesëmarrjes së komuniteteve lokale në përmirësimin e menaxhimit të ujit dhe kanalizimeve. Link: <https://sdgs.un.org/goals/goal6>

⁵ Resolution adopted by the General Assembly 58/217. International Decade for Action, “Water for Life”. Link: <https://documents-dds-ny.un.org/doc/UNDOC/GEN/N03/507/54/PDF/N0350754.pdf?OpenElement>

⁶ Resolution adopted by the Human Rights Council, 15/9: Human rights and access to safe drinking water and sanitation. Link: <https://documents-dds-ny.un.org/doc/UNDOC/GEN/G10/166/33/PDF/G1016633.pdf?OpenElement>

⁷ United Nations Guidelines for Consumer Protection. Link: https://unctad.org/system/files/official-document/ditccplpmisc2016d1_en.pdf

⁸ Çështja Tatar vs. Rumanisë (Aplikimi nr.67021/01), Çështja Branduse vs. Rumanisë (Aplikimi nr.39951/08) etj.

Një tjetër aspekt që kërkon vëmendje në trajtimin e këtij rasti është çështja e pretendimeve të ngritura nga banorët për trajtim të diferencuar apo diskriminim. Në përgjigjen e UKD, nr. 1379/3 datë 13.03.2023 pohohet se furnizimi i fshatit Borakë me ujë në orare të papërshtatshme për shkak të pozicionit të tij gjeografik, *krijon perceptimin e gabuar se këta banorë trajtohen në mënyrë të diferencuar*. Megjithatë, Avokati i Popullit thekson se afati i gjatë i mosofrimit të zgjidhjes teknike, pavarësisht identifikimit të saj nga ana e strukturave përgjegjëse, është shqetësim që mund të legjitimojë pretendimet e banorëve për trajtim të diferencuar apo diskriminim. Në këto kushte, zgjidhja e kësaj problematike duhet të jetë imediate.

Qasja që pritet të kenë strukturat shtetërore në këtë rast, për të mundësuar zgjidhjen e problemit, duhet të jetë proaktive dhe në funksion të interesit më të lartë publik.

Mungesa e reagimit të shpejtë apo ofrimit të një zgjidhje të qëndrueshme minon besimin e qytetarëve tek shteti dhe administrata publike, ndërkohë që të gjitha përpjekjet në nivel ndërkombëtar janë të drejtuara tek ruajtja dhe përmirësimi i besimit të publikut, indikator i cili zberthehet në mënyrë konkrete nën objektivat 16.6⁹, 16.7¹⁰ e 16.10¹¹ të Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm të Kombeve të Bashkuara. Rritja e standardit të veprimtarisë administrative që ushtrojnë organet e administratës në cdo nivel është në qendër të politikave dhe angazhimeve të shtetit shqiptar në kuadër të procesit të integritimit në Bashkimin Europian dhe përafrimit të legjislacionit tonë me Acquis Communautaire. Një iniciativë që tregon angazhim në këtë drejtim është *Dokumenti i politikave të standardeve të shërbimeve në Shqipëri*, i cili shqyrton sfidat që hasen në përkufizimin e standardeve të shërbimeve publike, si dhe paraqet kornizën e përgjithshme dhe zgjidhjet praktike të politikave për të nxitur zhvillimin e standardeve të shërbimeve që u ofrohen qytetarëve¹². Megjithatë, sjellja administrative refuzuese ndaj kërkesës për bashkëpunim nga një institucion kushtetues, vendos në pikëpyetje qasjen e hapur e bashkëpunuese që mund e duhet të ketë të një institucion ndaj qytetarëve.

Qasja proaktive e në zbatim të detyrimit për mirëadministrim e mirëqeverisje (e cila afirmohet në mënyrë të veçantë nga Karta e të Drejtave Themelore e BE, si një koncept i cili nevojitet të përvetësohet në veprimtarinë e përditshme të organeve publike), duhet të reflektohet në zgjidhjen e rastit konkret.

Zgjidhja e ofruar nga ana e shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime Durrës Sh.A, që është vendosja e një pompe me kapacitet të lartë përcjellës, e cila do të sigurojë furnizimin me ujë në sasinë dhe presionin e duhur, për të gjithë banorët e zonës së fshatit Borakë, është fillesa e një veprimi të munguar, që do të sigurojë zgjidhjen përfundimtare të problematikës së parashtruar në këtë rekomandim. Megjithatë, qasja në përputhje me standardet më të larta të mirëadministrimit kërkon jo vetëm marrjen e masave për ofrimin e shërbimit, apo zgjidhjen e problematikës, por edhe zbatimin e mekanizmave të qëndrueshëm për kontrollin apo vlerësimin e dhënies së shërbimit në parametra normale.

Për sa më sipër, në mbështetje të pikës 3, të nenit 63, të Kushtetutës, ku thuhet shprehimisht se:

⁹ Të zhvillohen institucione efektive, të përgjegjshme dhe transparente në të gjitha nivelet;

¹⁰ Vendimmarrje të përgjegjshme, gjithëpërfshirëse, pjesëmarrëse dhe përfaqësuese në të gjitha nivelet;

¹¹ Sigurimi i aksesit publik në informacion dhe mbrojtja e lirive themelore, në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe marrëveshjet ndërkombëtare;

¹² Dokument politikash për Standardet e Shërbimeve Publike në Shqipëri - <https://konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/532>

“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”,

dhe në vijim të nenit 21/b, të Ligjit nr.8454 datë 4.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, ku thuhet shprehimisht se:

“Pas përfundimit të hetimit, Avokati i Popullit kryen këto veprime:

- *paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që, sipas tij, ka shkaktuar shkelje të të drejtave të njeriut...”.*

REKOMANDOJMË

(i) Marrjen e masave të menjëhershme për furnizimin normal me ujë të pijshëm dhe brenda kushteve higjeno-sanitare të fshatit Borakë, Njësia Administrative Sukth, Bashkia Durrës.

(ii) Realizimin në një kohë sa më të shpejtë të mundshme, të ndërhyrjes së nevojshme me investime nga ana e Bashkisë Durrës, në bashkëpunim me Ujesjellës Kanalizime Durrës sh.a, për zgjidhjen e problematikës së konstatuar për kushtet e furnizimit me ujë të pijshëm të fshatit Borakë.

Në përputhje me nenin 22, të Ligjit nr.8454 datë 4.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, plotësuar me Ligjin nr.8600 datë 10.04.2000, ndryshuar me Ligjin nr.9398 datë 12.05.2005, ku përcaktohet se:

“Organet të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar një rekomandim, duhet ta shqyrtojnë rekomandimin dhe të kthejnë përgjigje brenda 30 ditësh nga data e dërgimit të rekomandimit”,

lutemi, pas shqyrtimit, të n’a vini në dijeni për qëndrimin ndaj këtij rekomandimi.
Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

K O M I S I O N E R E

Vilma SHURDHA